



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 99, datë 21.06.2019

**PËR
PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT
GENTJAN MARKU NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË
SHKODËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, në vendimin nr. 91, datë 17.06.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsiderate dhënien e pëlqimit të gjyqtarit Gentjan Marku me shkresën nr. 3317, datë 20.06.2019, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtarit Gentjan Marku, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, deri më datë 15.09.2019.
2. Gjyqtari Gentjan Marku të përjashtohet nga shorti i çështjeve gjyqësore gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm, deri më datë 15.09.2019, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me përjashtim të “çështjeve gjyqësore urgjente” në kuptim të nenit 2, shkronja “c”, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për të cilat duhet të përfshihet në short deri më datë 31.08.2019.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit Gentjan Marku, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë si dhe Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR